

RELACION

MBI PROJEKTLIGJIN "PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7651. DATË 21.12.1992, "PËR FESTAT ZYRTARE E DITËT PËRKUJTIMORE", TË NDRYSHUAR"

Projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr.7651. datë 21.12.1992. "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të ndryshuar", ka për qëllim shtimin si ditë pushimi zyrtar/festë zyrtare datën 7 janar si dita e Krishtlindjeve sipas kalendarit Julian për pakicat kombëtare maqedonase, sërbe dhe malazeze të besimit ortodoks.

Të krishterët ortodoks në Europën lindore por edhe pjesë të tjera të botës e festojnë Krishtlindjen më 7 janar, bazuar në kalendarin Julian.

Festa e Krishtlindjes është një ndër festat më të rëndësishme për të krishterët ortodoks dhe për këtë qëllim, festimi i tyre në mënyrë dinjitoze është një domosdoshmëri për të gjitha pakicat kombëtare maqedonase, sërbe dhe malazeze të besimit ortodoks.

Aktualisht ligji nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", në nenin 12, pika 2, ka përcaktuar: "Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, gëzojnë, në përputhje me përcaktimet e nenit 2, të këtij ligji, të drejtën e krenimit të ngjarjeve që lidhen me promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor."

Nga analizimi i dispozitave të ligjit nr.7651. datë 21.12.1992. "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të ndryshuar", konstatoj se kjo e drejtë specifike e këtyre pakicave nuk gjen zbatim dhe nuk është reflektuar.

Për të mundësuar gjithë sa më sipër, projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr.7651. datë 21.12.1992. "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të ndryshuar", do të mundësojë shtimin si ditë pushimi/festë zyrtare data 7 janar si dita e Krishtlindjeve sipas kalendarit Julian për pakicat kombëtare maqedonase, sërbe dhe malazeze të besimit ortodoks.

Vlerësoj se ky propozim do të mundësojë adresimin dhe garantimin e të drejtave për pakicat kombëtare maqedonase, sërbe dhe malazeze të besimit ortodoks.